tjerët si dhe të shkaktoni dëme materiale.

- ▶ Lexoni me kujdes udhëzuesin përkatës dhe dokumentet bashkëngjitur veçanërisht kapitullin "Siguria" dhe paralajmërimet.
- ▶ Si përdorues, ndërmerrni vetëm veprimet, për të cilat ju udhëzon ky udhëzues dhe që nuk janë të shënuara me simbolin

## 1.4 -- Siguria/Rregulloret

### 1.4.1 Rrezik i një dëmi material nga ngrica

- ▶ Instalojeni produktin vetëm në ambiente jo të rrezikuara nga ngrica.

### 1.4.2 Rrezik i një dëmi material si pasojë e përdorimit të veglave të papërshtatshme

- ▶ Përdorni një vegël të posaçme.

### 1.4.3 Rregullore (Direktiva, Ligje, Norma)

- ▶ Respektoni rregulloret, normat, direktivat, aktet dhe ligjet kombëtare.



## 2 Përshkrimi i produktit

### 2.1 Çfarë emërtimi do të përdoret?

- Çelësi rregullues: në vend të **VRT 380f**
- Telekomanda: në vend të **VR 92**

### 2.2 Çfarë nënkupton funksioni i mbrojtjes nga ngrica?

Modaliteti i mbrojtjes nga ngrica mbron impiantin e ngrohjes dhe banesën nga dëmet e ngricës.

Kur temperaturat e jashtme

- janë nën 4 °C për më shumë se 4 orë, çelësi rregullues do ta ndezë gjeneratorin e nxehtësisë dhe do të rregullojë temperaturën e nominale të dhomës në të paktën °C.
- mbi 4 °C, çelësi rregullues nuk e ndez gjeneratorin e nxehtësisë, por monitoron temperaturën e jashtme.

### 2.3 Çfarë do të thonë temperaturat e mëposhtme?

**Temperatura e dëshiruar** është temperatura, në të cilën duhet të ngrohen dhomat e ditës.

**Temperatura e reduktimit** është temperatura që nuk duhet të nënkalohet në dhomat e ditës jashtë kuadrit kohor.

**Temperatura e rrjedhës** është temperatura, me të cilën uji i ngrohtë del nga gjeneratori i nxehtësisë.

### 2.4 Çfarë është një zonë?

Një godinë mund të jetë e ndarë në disa hapësira që quhen zona. Çdo zonë mund të ketë një kriter tjetër në impiantin nxehtës.

Shembuj për ndarjen në zona:


- Në një shtëpi ka një sistem ngrohës në dysheme (zona 1) dhe një pajisje ngrohëse të sheshtë (zona 2).
- Në një shtëpi ndodhen më shumë njësi të pavarura banimi. Çdo njësi banimi ka zonën e saj personale.

### 2.5 Çfarë është qarkullimi?

Një tubacion shtesë i ujit lidhet me tubacionin e ujit të ngrohtë dhe ndërton një qark me rezervuarin e ujit të ngrohtë. Një pompë qarkullimi kujdeset për qarkullimin e vazhdueshëm të ujit të ngrohtë në sistemin e linjës së tubave, në mënyrë që të ketë menjëherë ujë të ngrohtë edhe në vendet e largët të shpërndarjes.

### 2.6 Çfarë do të thotë kuadër kohor?

Shembull i procesit të nxehtësisë në modalitetin: me komandim kohor



A	Ora	3	Intervali 2
B	Temperatura	4	jashtë kuadrit kohor
1	Temperatura e dëshiruar	5	Intervali 1
2	Temp. e reduktimit		

Ju mund ta ndani një ditë në më shumë kuadro kohore (3) dhe (5). Çdo kuadër kohor mund të përfshijë një hapësirë kohore individuale. Kuadrot kohore nuk duhet të mbivendosen. Çdo kuadri kohor mund t'i caktoni një temperaturë tjetër të dëshiruar (1).

Shembull:

ora 16:30 deri 18:00; 21 °C

ora 20:00 deri 22:30; 24 °C

Çelësi rregullues rregullon brenda një kuadri kohor temperaturën e dhomave të ditës në temperaturën e dëshiruar. Në kohët jashtë kuadrit kohor (4), çelësi


## 2 Përshkrimi i produktit

rregullues rregullon temperaturën e dhomave të ditës sipas temperaturës së ulët të konfiguruar të reduktimit (2).

### 2.7 Shmangni funksionin e defektit


- Mos e pengoni çelësin rregullues me mobilie, perde ose objekte të tjera.
- Nëse çelësi rregullues është montuar në dhomë, hapini plotësisht të gjithë valvulat e termostatit të radiatorit që ndodhen në këtë dhomë.

### 2.8 Vendosni grafikun e ngrohjes



A Temperatura e jashtme °C      B temperatura nominale e rrjedhës °C


Figura tregon grafikët e mundshëm të ngrohjes nga 0,1 deri 4.0 për një temperaturë dhome 20 °C. Kur zgjidhet p.sh. grafiku i ngrohjes 0.4, atëherë me një temperaturë të jashtme prej -15 °C rregullohet me një temperaturë të rrjedhës prej 40 °C.



A Temperatura e jashtme °C      C Temperatura nominale e dhomës °C  
B temperatura nominale e rrjedhës °C      D Aksi a

Kur zgjidhet grafiku i ngrohjes 0.4 dhe është vendosur temperatura nominale e dhomës prej 21 °C, atëherë grafiku i ngrohjes shtyhet siç paraqitet në figurë. Në aksin e përshtatshëm 45°, grafiku i ngrohjes shtyhet përkatësisht sipas vlerës së temperaturës së dhomës paralelisht. Në një temperaturë të jashtme prej -15 °C, rregullimi kujdeset për një temperaturë të rrjedhës prej 45 °C.





### 2.9 Ekran, elementet komanduese dhe simbolet




#### 2.9.1 Elementet shërbyese


- ☰ – Thirrja e menisë
- ← – Kthehu në menunë kryesore
- ✓ – Konfirmo zgjedhjen/ndryshimin
- Ruaj vlerat rregulluese

## Përshkrimi i produktit 2







	<ul style="list-style-type: none"><li>- Kthehu një fushë më mbrapa</li><li>- Ndërprit komandat</li></ul>
	<ul style="list-style-type: none"><li>- Lundro nëpër strukturën e menusë</li><li>- Zvogëlimi ose rritja e vlerës së rregullimit</li><li>- Lundro nëpër numrat/germa</li></ul>
	<ul style="list-style-type: none"><li>- Shfaq ndihmën</li><li>- Shfaq asistentin e programit me kohë</li></ul>
	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ndizni ekranin</li><li>- Fikni ekranin</li></ul> <p>Elementi i komandimit ndodhet në anën e sipërme të çelësit rregullues.</p>

Elementet aktive të komandimit ndriçojnë në ngjyrë të gjelbër.

Shtypni 1 x : Do të shkoni në treguesin bazë.


Shtypni 2 x : Do të shkoni te menuja.

### 2.9.2 Simbolet

	Gjendja e karikimit të baterive
	Fuqia e sinjalit
	Ngrohja me komandim me kohë aktive
	Nevojitet mirëmbajtje
	Defekt në impiantin nxehës
	Kontaktoni teknikun profesionist

## 2 Përshkrimi i produktit

### 2.10 -- Përdorimi i çelësit rregullues



Çelësi rregullues do të montohet në sisteme të thjeshta me qarqe ngrohës të drejtpërdrejtë.



#### Udhëzim

Pas lidhjes së një sensori të jashtëm, çelësi rregullues punon në varësi të motit.

### 2.11 Funksonet e komandimit dhe të treguesve




#### Udhëzim

Funksionet e përshkruara në këtë kapitull nuk janë të disponueshme për gjithë konfigurimet e sistemit.

Produkti ka dy fusha komandimi dhe të treguesve.

Në fushën e komandimit do të gjeni informacione dhe mundësi rregullimi që ju nevojiten si përdorues.

 -- Fusha e specialistit është e rezervuar për teknikun e specializuar. Ajo ruhet me një kod. Vetëm teknikët e specializuar mund të kryejnë rregullime në fushën e specialistit.

Për të hapur menunë, shtypni 2 x .

#### 2.11.1 Pika e menisë RREGULLIMI

MENUJA → RREGULLIMI		
→ Zona		
→ Emri i zonës	Ndryshoni emrat e vendosur nga fabrika <b>Zona 1</b>	
→ Modaliteti:	→ Manual	→ Temperatura e dëshiruar: °C
	Ruajtja pa ndërprerje e temperaturës së dëshiruar	
	→ Kom.me kohë	→ Plani javor
	→ Temperatura e rënies: °C	

## Përshkrimi i produktit 2


MENUJA → RREGULLIMI											
→ <b>Modaliteti:</b>	<p><b>Plani javor:</b> mund të vendosen deri në 12 kuadro kohore dhe temperatura të dëshiruara në ditë</p> <p>Specialisti vendos reagimin e impiantit nxehtë jashtë kuadrove kohore, në funksionin <b>Modal. i reduktimit</b>.</p> <p>Në <b>Modal. i reduktimit:</b> do të thotë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– <b>Eko:</b> Ngrohja është fikur jashtë kuadrove kohore. Mbrojtja nga ngrica është aktivizuar.</li> <li>– <b>Normal:</b> Temperatura e reduktimit është e vlefshme jashtë kuadrit kohor.</li> </ul> <p><b>Temperatura e dëshiruar: °C:</b> është e vlefshme brenda kuadrit kohor</p> <p>→ <b>Fikur</b></p> <p>Ngrohja është mbyllur, uji i ngrohtë vazhdon të jetë i disponueshëm, mbrojtja nga ngrica është aktivizuar</p>										
→ <b>Në mungesë</b>	<p>→ <b>Të gjitha:</b> është e vlefshme për gjithë zonat në hapësirën e dhënë kohore</p> <p>→ <b>Zona:</b> është e vlefshme për zonën e zgjedhur në hapësirën e dhënë kohore</p> <p>Regjimi i ngrohjes dhe procesi me ujë të ngrohtë janë fikur, mbrojtja nga ngrica është aktivizuar</p>										
→ <b>uji i ngrohtë</b>											
→ <b>Modaliteti:</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>→ <b>Manual</b></th> <th><b>Temperatura e ujit të ngrohtë</b></th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td colspan="2">Ruajtja pa ndërprerje e temperaturës së ujit të ngrohtë</td> </tr> <tr> <td>→ <b>Kom.me kohë</b></td> <td>→ <b>Plani javor i ujit të ngrohtë</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td>→ <b>Temperatura e ujit të ngrohtë: °C</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td>→ <b>Plani javor i qarkullimit</b></td> </tr> </tbody> </table> <p><b>Plani javor i ujit të ngrohtë:</b> mund të vendosen deri në 3 kuadro kohore në ditë</p> <p><b>Temperatura e ujit të ngrohtë: °C:</b> është e vlefshme brenda kuadrit kohor</p> <p>Jashtë kuadrit kohor, regjimi i ujit të ngrohtë fiket</p> <p><b>Plani javor i qarkullimit:</b> mund të vendosen deri në 3 kuadro kohore në ditë</p> <p>Brenda kuadrit kohor, pompa e qarkullimit pompon ujë të ngrohtë tek vendet e shpërndarjes</p> <p>Jashtë kuadrit kohor, pompa e qarkullimit fiket</p> <p>→ <b>Fikur</b></p> <p>Funksioni i ujit të ngrohtë është i fikur</p>	→ <b>Manual</b>	<b>Temperatura e ujit të ngrohtë</b>	Ruajtja pa ndërprerje e temperaturës së ujit të ngrohtë		→ <b>Kom.me kohë</b>	→ <b>Plani javor i ujit të ngrohtë</b>		→ <b>Temperatura e ujit të ngrohtë: °C</b>		→ <b>Plani javor i qarkullimit</b>
→ <b>Manual</b>	<b>Temperatura e ujit të ngrohtë</b>										
Ruajtja pa ndërprerje e temperaturës së ujit të ngrohtë											
→ <b>Kom.me kohë</b>	→ <b>Plani javor i ujit të ngrohtë</b>										
	→ <b>Temperatura e ujit të ngrohtë: °C</b>										
	→ <b>Plani javor i qarkullimit</b>										
→ <b>Uji i ngrohtë i shpejtë</b>	Ngrohja e njëhershme e ujit në rezervuar										
→ <b>Ventilim periodik</b>	Regjimi i ngrohjes është fikur për 30 minuta.										
→ <b>Asistenti i programit me kohë</b>	<p>Programimi i temperaturës së dëshiruar nga e hëna në të premte dhe nga e shtuna në të diel; programimi është i vlefshëm për funksionet e komanduara me kohë <b>Ngrohja, uji i ngrohtë dhe qarkullimin.</b></p> <p>Nëse plani javor mbivendoset për funksionet <b>Ngrohja, uji i ngrohtë dhe qarkullimin.</b></p>										
→ <b>Impianti i fikur</b>	Impianti është i fikur. Mbrojtja nga ngrica mbetet e aktivizuar										

## 2 Përshkrimi i produktit

### 2.11.2 Pika e menisë INFORMACIONIN

MENUJA → INFORMACIONI	
→ Temperaturat aktuale	
→ Zona	
→ Temp. e ujit të ngrohtë	
→ Presioni i ujit: bar	
→ Gjendja e djegësit:	
→ Elementet shërbyese	Shpjegimi i elementëve të komandimit
→ Paraqitja e menisë	Shpjegimi i strukturës së menisë
→ Kontakti i teknikut profesionist	
→ Serial number	

### 2.11.3 -- Pika e menisë CILËSIMET

MENUJA → RREGULLIMET	
 → Niveli i specialistit	
→ Futni kodin e hyrjes	Hyrja në nivelin e specialistit, parametri i fabrikës: 00
→ Kontakti i teknikut profesionist	Regjistroni të dhënat e kontaktit
→ Data e mirëmbajtjes:	Regjistroni datën më të afërt të mirëmbajtjes së një komponenti të lidhur, p.sh. të gjeneratorit të nxehtësisë
→ Historiku i defekteve	Për momentin, gabimet listohen të klasifikuar
→ Konfigurimi i impiantit	Funksionet (→ Pika e menisë <b>Konfigurimi i impiantit</b> )
→ Tharja e mastarit	Aktivizoni funksionin <b>Profili i tharjes së mastarit</b> për shtrimin e mastarit të njomë sipas rregullave të ndërtimit. Çelësi rregullues konfiguron temperaturën e rrjedhës, pavarësisht temperaturës së jashtme. Vendosni tharjen e mastarit (→ Pika e menisë <b>Konfigurimi i impiantit</b> )
→ Ndryshimi i kodit	
→ Gjuha, ora, ekrani	
→ Gjuha:	
→ Data:	Pas heqjes së korrentit, data vazhdon të qëndrojë edhe 30 minuta.
→ Ora:	Pas heqjes së korrentit, ora vazhdon të qëndrojë edhe 30 minuta.
→ Ndryshimi i ekranit:	
→ Stina e verës:	→ <b>Automatik</b>
	→ <b>Manual</b>
Në rastin e sensorëve të temperaturës së jashtme me marrës DCF77, nuk përdoret funksioni <b>Stina e verës</b> . Ndërrimi midis orës verore dhe dimërore bëhet përmes sinjalit DCF77. Ndryshimi fillon:	
<ul style="list-style-type: none"> <li>– fundjavën e fundit në mars në orën 2:00 (ora verore)</li> <li>– fundjavën e fundit në mars në tetor 3:00 (ora dimërore)</li> </ul>	
→ Vlera e korrigjimit	

## Përshkrimi i produktit 2

MENUJA → RREGULLIMET	
→ Temperatura e dhomës: K	Balancimi i diferencës së temperaturës midis vlerës së matur në çelësin rregullues dhe vlerës së një termometri reference në dhomë.
→ Temperatura e jashtme: K	Balancimi i diferencës së temperaturës midis vlerës së matur në sensorin e temperaturës së jashtme dhe vlerës së një termometri reference në mjedis të jashtëm.
→ Rregullimet nga fabrika	Çelësi rregullues rivendos gjithë konfigurimet në parametrat e fabrikës dhe thërret asistentin e instalimit. Asistentin e instalimit mund ta përdorë vetëm tekniku profesionist.

### 2.11.4 -- Pika e menisë Konfigurimi i impiantit

MENUJA → RREGULLIMET → Niveli i specialistit Konfigurimi i impiantit	
→ Implantit	
→ Presioni i ujit: bar	
→ Komponentët-eBUS	Lista e komponentëve eBUS dhe të versionit të softuerit të tyre
→ Kurba adapt. e ngroh.:	Kalibrimi automatik i grafikut të nxehtësisë. Kusht paraprak: <ul style="list-style-type: none"> <li>– Grafiku i përshtatshëm i nxehtësisë për godinën është konfiguruar në funksionin <b>Kurba e ngrohjes</b>.</li> <li>– Çelësit rregullues ose komandimit në distancë i është caktuar zona e duhur në funksionin <b>Renditja e zonave</b>.</li> <li>– Në funksionin <b>Aktivizimi i ambientit</b>: është zgjedhur <b>Zgjeruar</b>.</li> </ul>
→ Rregullimi:	<b>Tem.mje.rën</b> Rregullimi bëhet përmes temperaturës së dhomës.
	<b>Kush.mot.rën</b> Rregullimi bëhet përmes temperaturës së dhomës, sapo të jetë lidhur sensori i temperaturës së jashtme.
→ Gjeneratori i nxehtësisë 1	
→ Statusi:	
→ Temp. aktuale e rrjedhës: °C	
→ Qarku 1	
→ Statusi:	
→ Temp. nominale e rrjedhës: °C	
→ Kufiri i çaktiv.temp.jasht.: °C	Vendosni kufirin e sipërm për temperaturën e jashtme. Nëse temperatura e jashtme rritet mbi vlerën e vendosur, çelësi rregullues çaktivizon procesin e nxehtësisë.
→ Kurba e ngrohjes:	Grafiku i nxehtësisë (→ Kapitulli Përshkrimi i produktit) është varësia e temperaturës së rrjedhës nga temperatura e jashtme për temperaturën e dëshiruar (temperatura nominale e dhomës).
→ Temp. min. nom. e rrjedhës: °C	Vendosni kufirin e poshtëm për temperaturën e rrjedhës. Çelësi rregullues njëtrajtëson vlerën e caktuar me temperaturën e përlogaritur nominale të rrjedhës dhe rregullohet në vlerën më të lartë.

## 2 Përshkrimi i produktit

MENUJA → RREGULLIMET → Niveli i specialistit Konfigurimi i impiantit	
→ Temp. maks. nom. e rrjedhës: °C	Vendosni kufirin e sipërm për temperaturën e rrjedhës. Çelësi rregullues njëtrajtëson vlerën e caktuar me temperaturën e përlogaritur nominale të rrjedhës dhe rregullohet në vlerën më të ulët.
→ Modal. i reduktimit:	
	<p>→ <b>Eko</b></p> <p>Funksioni i nxehtjes është i fikur dhe funksioni i mbrojtjes nga ngrica është aktiv. Kur temperaturat e jashtme qëndrojnë nën 4 °C për më shumë se 4 orë, çelësi rregullues ndez gjeneratorin e nxehtësisë dhe e konfiguron në <b>Temperatura e rënies: °C</b>. Kur temperatura e jashtme është mbi 4 °C, çelësi rregullues e fik gjeneratorin e nxehtësisë. Monitorimi i temperaturës së jashtme qëndron aktiv. Reagimi i qarkut ngrohës jashtë kuadrit kohor. Kusht paraprak:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Funksioni <b>Ngrohja</b> → <b>Modaliteti</b>: është <b>Kom.me kohë</b> i aktivizuar.</li> <li>– Funksioni <b>Aktivizimi i ambientit</b>: aktivizohet <b>Aktiv</b> ose <b>Joaktiv</b>.</li> </ul> <p>Kur <b>Zgjeruar</b> aktivizohet në <b>Aktivizimi i ambientit</b>, çelësi rregullues konfiguron në mënyrë të pavarur nga temperatura e jashtme, në temperaturën nominale të dhomës prej 5 °C.</p>
	<p>→ <b>Normal</b></p> <p>Funksioni i nxehtjes është i aktivizuar. Çelësi rregullues konfiguron në <b>Temperatura e rënies: °C</b>. Kusht paraprak:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Funksioni <b>Ngrohja</b> → <b>Modaliteti</b>: është <b>Kom.me kohë</b> i aktivizuar.</li> </ul>
Reagimi është i rregullueshëm veçmas për çdo qark ngrohës.	
→ <b>Aktivizimi i ambientit</b> :	
	<p>→ <b>Joaktiv</b></p>
	<p>→ <b>Aktiv</b></p> <p>Përshtatja e temperaturës së rrjedhës në varësi të temperaturës aktuale të dhomës.</p>
	<p>→ <b>Zgjeruar</b></p> <p>Përshtatja e temperaturës së rrjedhës në varësi të temperaturës aktuale të dhomës. Gjithashtu, çelësi rregullues aktivizon/çaktivizon zonën.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Zona do të çaktivizohet: temperatura aktuale e dhomës &gt; temperatura e vendosur e dhomës + 2/16 K</li> <li>– Zona do të aktivizohet: temperatura aktuale e dhomës &lt; temperatura e vendosur e dhomës - 3/16 K</li> </ul>

## Përshkrimi i produktit 2

MENUJA → RREGULLIMET → Niveli i specialistit Konfigurimi i impiantit		
<p>Sensori i integruar i temperaturës mat temperaturën aktuale të dhomës. Çelësi rregullues arrin një temperaturë të re nominale të dhomës, e cila përdoret për përshtatjen e temperaturës së rrjedhës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Diferenca = temperatura e vendosur nominale e dhomës - temperatura aktuale e dhomës</li> <li>– Temperatura e re nominale e dhomës = temperatura e vendosur nominale e dhomës + diferenca</li> </ul> <p>Kusht paraprak: Çelësi rregullues ose komandimi në distancë është caktuar në funksionin <b>Renditja e zonave</b>: të zonës, ku është instaluar çelësi rregullues ose komandimi në distancë. Funksioni <b>Aktivizimi i ambientit</b>: nuk ka efekt, nëse <b>Pa renditje</b> është aktivizuar në funksionin <b>Renditja e zonave</b>:</p>		
→ Lloji i rregullimit:	<b>Pika 2</b>	Përkon me rregullimin/kompensimin
	<b>Analog</b>	Përkon me një rregullim me modulim
→ <b>Zona</b>		
→ <b>Zona e aktivizuar:</b>	Çaktivizoni zonat e nevojshme. Të gjitha zonat e disponueshme do të shfaqen në ekran.	
→ <b>Renditja e zonave:</b>	Kaktujini çelësit rregullues zonat e zgjedhura. Çelësi rregullues duhet të jetë i instaluar në zonat e zgjedhura. Rregullimi përdor gjithashtu sensorin e temperaturës së dhomës së pajisjes së sistemuar. Nëse nuk i keni caktuar asnjë zonë çelësit rregullues, funksioni <b>Aktivizimi i ambientit</b> : nuk ka efekt.	
→ <b>Stat.valv.të zonave:</b>		
→ <b>uji i ngrohtë</b>		
→ <b>Rezervuari:</b>	Në rezervuarin e disponueshëm të ujit të ngrohtë duhet të zgjidhet cilësimi <b>Aktiv</b> .	
→ <b>Temp. nominale e rrjedhës: °C</b>		
→ <b>Pompa e qarkullimit:</b>		
→ <b>Dita e mbrojt. së leg.:</b>	Përcaktimi se në cilën ditë duhet të kryhet mbrojtja nga legionella. Atë ditë, (temperatura e ujit duhet të rritet mbi 60 °C. Pompa e qarkullimit do të ndizet. Funksioni përfundon jo më vonë se 120 minuta. Kur është aktiv funksioni <b>Në mungesë</b> , mbrojtja nga legionella nuk kryhet. Sapo përfundon funksioni <b>Në mungesë</b> , do të kryhet mbrojtja nga legionella.	
→ <b>Ora e mbrojt. së leg.:</b>	Përcaktimi se në cilën orë duhet të kryhet mbrojtja nga legionella.	
→ <b>Lidhja radio</b>		
→ <b>Forca marrëse e rregullatorit:</b>	Leximi i fuqisë marrëse midis njësisë së marrësit dhe sensorit të temperaturës së jashtme. – 4: Lidhja radio në largësi të mjaftueshme. Kur forca marrëse shkon < 4, lidhja radio nuk është stabil. – 10: Lidhja radio është shumë stabil.	

## 2 Përshkrimi i produktit

MENUJA → RREGULLIMET → Niveli i specialistit Konfigurimi i impiantit	
→ <b>Forca marr.e sens.të temp.jasht.:</b>	Leximi i fuqisë marrëse midis njësisë së marrësit dhe sensorit të temperaturës së jashtme. – 4: Lidhja radio në largësi të mjaftueshme. Kur forca marrëse shkon < 4, lidhja radio nuk është stabël. – 10: Lidhja radio është shumë stabël.
→ <b>Profil i tharjes së mastarit</b>	Vendosja e temperaturës nominale të rrjedhës për çdo ditë, në përputhje me rregulloret e ndërtimit

### 3 -- Instalimet elektrike, montimi

Pengesat dobësojnë forcën marrëse midis njësisë marrëse të valëve radio dhe çelësit rregullues ose sensorit të temperaturës së jashtme.

Instalimi elektrik duhet të kryhet vetëm nga një electricist.

Impianti nxehtës duhet të nxirret jashtë pune, para se të kryhen punime në të.

#### 3.1 Kontrolloni përmbajtjen e ambalazhit

Numri	Përmbajtja
1	Çelësi rregullues
1	Njësia e marrësit të valëve radio
1	Materiali shtrëngues (2 vida dhe 2 upa)
4	Bateritë, tipi LR06
1	Dokumentacioni

- ▶ Kontrolloni përmbajtjen e ambalazhit nëse është i plotë.

#### 3.2 Zgjedhja e kablove

- ▶ Përdorini për instalimet elektrike të kablove komercialë.
- ▶ Për kabllot e tensionit të rrejtë, mos përdorni kablo fleksibël.
- ▶ Për kabllot e tensionit të rrejtë përdorni kablo me këmishë (p.sh. NYM 3x1,5).

#### Prerja tërthore e kabllit

Tubacionet eBUS (tension i ulët)	$\geq 0,75 \text{ mm}^2$
Kablli i sensorit (tension i ulët)	$\geq 0,75 \text{ mm}^2$

#### Gjatësia e kablove

Kabllot e sensorit	$\leq 50 \text{ m}$
Kabllot bus	$\leq 125 \text{ m}$

#### 3.3 Polariteti

Kur lidhni kabllin eBUS, nuk duhet të merrni parasysh polaritetin. Nëse këmbeni tubacionet, komunikimi nuk ndikohet.


#### 3.4 Instaloni njësinë e marrësit

Njësia e marrësit mund të instalohet në një gjenerator nxehtësie.

Me instalimin e njësisë së marrësit në një gjenerator nxehtësie edhe jashtë zonave të lagështa, njësia e marrësit mund të montohet në mur dhe të lidhet me anë të një kabli zgjatues, për përmirësimin e fuqisë marrëse.

#### 3.4.1 Montoni njësinë e marrësit dhe lidhni te gjeneratori i nxehtësisë


**Kushti:** Gjeneratori i nxehtësisë ka një mundësi për lidhjen e drejtpërdrejtë dhe nuk është instaluar në një zonë të lagësht.




- ▶ Montojeni njësinë e marrësit nën gjeneratorin e nxehtësisë.
- ▶ Lidhni njësinë e marrësit me lidhje të drejtpërdrejtë nën gjeneratorin e nxehtësisë. Drita LED ndizet jo më vonë se 20 sekonda në ngjyrë të gjelbër.

### 3 -- Instalimet elektrike, montimi


**Kushti:** Gjeneratori i nxehtësisë nuk ka një mundësi për lidhjen e drejtpërdrejtë dhe/ose është instaluar në një zonë të lagësht.




- ▶ Hiqni kllapën e njësisë së marrësit sipas figurës.
- ▶ Hiqni kabljin ekzistues për lidhjen e drejtpërdrejtë.



- ▶ Lidhni kabljin eBUS që duhet vendosur nga klienti, sipas figurës.
- ▶ Mbyllni kllapën e njësisë së marrësit.




- ▶ Montoni vidat e varjes sipas figurës, jashtë zonës së lagësht.
- ▶ Vendosni njësinë e marrësit te vidat e varjes.



- ▶ Gjatë hapjes së kutisë së çelësave të gjenerorit të nxehtësisë, si përkruhet në manualin e instalimit të gjenerorit të nxehtësisë.
- ▶ Lidhni njësinë e marrësit përmes kablilit zgjatues, sipas figurës, te porta eBUS në kutinë e kontrollit të gjenerorit të nxehtësisë. Drita LED ndizet jo më vonë se 20 sekonda në ngjyrë të gjelbër.

#### 3.5 Montoni rregullatorin

1. Lexoni deri në fund konceptin e përdorimit dhe shembujt përkatës që përkruhen në udhëzuesin e përdorimit të çelësit rregullues.
2. Qëndroni pranë njësisë marrëse të valëve radio.



3. Hapni folenë e baterive të çelësit rregullues, sipas figurës.
4. Vendosini bateritë sipas poleve të sakta.
  - ◀ Asistenti i instalimit starton.
5. Mbyllni folenë e baterive.



## -- Instalimet elektrike, montimi 3

6. Zgjidhni gjuhën.
7. Rregulloni datën.
8. Rregulloni orën.
  - ◁ Asistenti i instalimit kalon tek funksioni **Forca marrëse e rregullatorit**.

**Kushti:** Sensori i temperaturës së jashtme-me valë radio i pranishëm

- ▶ Nëse ka një sensor të temperaturës së jashtme, duhet të programohet. Për këtë, ndiqni gjithë udhëzimet e montimit në udhëzuesin përkatës.
- ▶ Për programimin e sensorit të temperaturës së jashtme me valë radio, shtypni butonin në njësinë e marrësit. Drita DEL pulson me ngjyrë të gjelbër.
- ▶ Aktivizoni sensorin e temperaturës së jashtme, siç përshkruhet në manualin përkatës. Drita DEL e njësisë së marrësit do të pulsojë shkurt. Kur procesi i programimit përfundon, drita DEL nuk pulson më.
- ▶ Shkoni tek vendi i zgjedhur i montimit të sensorit të temperaturës së jashtme me valë radio.
- ▶ Nëse fuqia marrëse në vendin e zgjedhur të montimit është  $< 4$ , përcaktoni një vend të ri montimi për sensorin e temperaturës së jashtme me një fuqi marrëse  $\geq 4$ .
- ▶ Montoni sensorin e temperaturës së jashtme në vendin e montimit.

### Përcaktoni vendin e montimit të çelësit rregullues tek godina

9. Përcaktoni vendin e montimit, i cili përputhet me kërkesat e listuara.
  - Muri i brendshëm i dhomës kryesore
  - Lartësia e montimit: 1.5 m
  - pa rrezatim të drejtpërdrejtë të diellit
  - pa ndikim të burimeve të nxehtësisë

### Përcaktoni forcën marrëse të çelësit rregullues në vendin e zgjedhur të montimit

10. Shkoni tek vendi i zgjedhur i montimit të çelësit rregullues.

11. Gjatë rrugës për tek vendi i montimit, mbyllni gjithë dyert.
12. Shtypni butonin e aktivizimit/ndezjes në pjesën e sipërme të pajisjes, nëse ekrani është i fikur.

**Kushti:** Ekrani është i ndezur, Në ekran shfaqet **Komunikimi radio u ndërpre**

- ▶ Sigurohuni që furnizimi me energji të jetë aktiv.


**Kushti:** Ekrani është i ndezur, **Forca marrëse e rregullatorit  $< 4$**

- ▶ Kërkoni një vend montimi për çelësin rregullues, ku të mund të marrë valë.


**Kushti:** Ekrani është i ndezur, **Forca marrëse e rregullatorit  $\geq 4$**

- ▶ Shënjoni vendin tek muri, ku marrja e valëve është e mjaftueshme.

### Montoni në mur mbajtësin e pajisjes




13. Largoni mbajtësin e pajisjes nga çelësi rregullues sipas figurës.



14. Fiksojeni mbajtësin e pajisjes sipas figurës.

## 4 -- Vënia në punë

### Futuri çelësin rregullues



15. Futuri çelësin rregullues sipas figurës në mbajtësin e pajisjes, derisa të mbërthehet.

## 4 -- Vënia në punë

### 4.1 Kushtet paraprake për vënien në punë

- Montimi dhe instalimi elektrik i çelësit rregullues dhe sensorit të temperaturës së jashtme ka përfunduar.
- Vënia në punë i gjithë komponentëve të sistemit (përveç çelësit rregullues) ka përfunduar.

### 4.2 Aktivizimi i asistentit të instalimit

Në asistentët e instalimit ndodhëni në kërkesën **Gjuha**.

Asistenti i instalimit të çelësit rregullues ju çon nëpër një listë funksionesh. Në çdo funksion, zgjidhni vlerën rregulluese, e cila përshtatet me impiantin e instaluar të nxehtësisë.

#### 4.2.1 Finalizoni asistentin e instalimit

Pasi të keni shfletuar asistentin e instalimit, në ekran do të shfaqet: **Zgjidhni hapin e radhës**.

**Konfigurimi i impiantit:** Asistenti i instalimit e ndryshon konfigurimin e sistemit të nivelit profesional, për të optimalizuar impiantin e nxehtësisë.

**Ndezja e impiantit:** Asistenti i instalimit e ndryshon treguesin bazë dhe impianti i nxehtësisë punon me vlerën e vendosur.

### 4.3 Ndërroni rregullimet më vonë

Gjithë rregullimet që keni ndërmarrë përmes asistentit të instalimit, mund t'i ndryshoni më vonë në fushën e komandimit për përdoruesin ose në nivelin profesional.

## 5 Defektet, njoftimet e gabimeve dhe të mirëmbajtjes

### 5.1 Njoftimi i defektit

Në ekran shfaqet  me tekstin e njoftimit të defektit.

Njoftimet e problemeve i gjeni nën: **MENUJA → RREGULLIMET → Niveli i specialistit Historiku i defekteve**  
Zgjidhja e problemeve (→ Shtojca)

### 5.2 Njoftimi për mirëmbajtje

Në ekran shfaqet  me tekstin e njoftimit të mirëmbajtjes.

Njoftimi i mirëmbajtjes (→ Shtojca)

### 5.3 Ndërrimi i baterive



#### Rrezik!

#### Bateritë e papërshtatshme përbëjnë rrezik për jetën!

Nëse bateritë zëvendësohen me tipin e gabuar të baterisë, ekziston rrezik shpërthimi.

- Bëni kujdes në zëvendësimin me tipin e duhur të baterive.

## Defektet, njoftimet e gabimeve dhe të... 5


- ▶ Bateritë e konsumuara hidhini sipas udhëzimeve në këtë udhëzues.




### Paralajmërim! Rrezik djegieje nga rrjedhja e baterive!

Nga bateritë e shkarkuara mund të rrjedhë lëngu gërryes i baterive.


- ▶ Bateritë e shkarkuara hiqini nga produkti sa më shpejtë të jetë e mundur.
- ▶ Në rast mungesash të gjata, hiqni nga produkti edhe bateritë që nuk janë shkarkuar ende.
- ▶ Shmangni kontaktin e lëkurës ose të syve me lëngun e rrjedhur të baterive.



1. Hiqni çelësin rregullues nga mbajtësi i pajisjes, sipas figurës.



2. Hapni folenë e baterive, sipas figurës.
3. Zëvendësojini gjithmonë të gjitha bateritë.
  - përdorni vetëm tipin e baterive LR06
  - mos përdorni bateri që rimbushen
  - mos kombinoni tipe të ndryshëm baterish
  - mos kombinoni bateri të reja me të përdorura
4. Vendosini bateritë sipas poleve të sakta.
5. Mos bëni lidhje të shkurtër në lidhjet e kontaktit.
6. Mbyllni folenë e baterive.



7. Vareni çelësin rregullues sipas figurës në mbajtësin e pajisjes, derisa të mbërthehet.

## 6 Informacioni për produktin

### 6 Informacioni për produktin

#### 6.1 Ndiqni dhe ruani dokumentet përkatëse

- ▶ Respektoni gjithë udhëzimet e parashikuara për ju, të komponentëve të impiantit.
- ▶ Si përdorues, ruajeni këtë manual si dhe dokumentet bashkëngjitur për përdorimin e ardhshëm.


#### 6.2 Vlefshmëria e udhëzimit

Ky manual vlen vetëm për:

– 0020260959

#### 6.3 Tabela e tipit

Etiketa e parametrave të tipit ndodhet në anën e pasme të produktit.

Të dhëna në pllakën e llojit të produktit	Domethënia
Serial number	për identifikim, shifra 7 deri 16 = numri i artikullit të produktit
<b>sensHOME</b>	Emërtimi i produktit
V	Tensioni i matur
mA	Rryma nominale
	Lexoni udhëzimin

#### 6.4 Numri serial

Numrat serialë mund t'i shfaqni nën **MENUJA → INFORMACION → Serial number**. Numri i artikullit me 10 shifra ndodhet në rreshtin e dytë.

#### 6.5 Shenja-CE



Me shenjën CE dokumentohet se produktet përmbushin kriteret bazë të gjitha direktivave në fuqi sipas Deklaratës së Konformitetit.

Përmes saj, prodhuesi sqaron se tipi i impiantit me valë radio që përshkruhet në

këtë udhëzues përputhet me direktivën 2014/53/të BE. Teksti i plotë i Deklaratës së Konformitetit të BE-së është i disponueshëm në adresën e mëposhtme të internetit: <http://www.vaillant-group.com/doc/doc-radio-equipment-directive/>.

#### 6.6 Garancia dhe shërbimi i klientëve

##### 6.6.1 Garancia

Informacionet e garancisë së prodhuesit i gjeni në Country specifics.

##### 6.6.2 Shërbimi i klientit

Të dhënat e kontaktit të shërbimit tonë të klientit i gjeni në faqen e pasme ose në faqen tonë të internetit.

#### 6.7 Riciklimi dhe deponimi

- ▶ Asgjësimin e ambalazhit lëreni ta kryejë tekniku profesionist që ka instaluar produktin.



■ Nëse produkti është i shënuar me këtë simbol:

- ▶ Në këtë rast mos e shkarkoni produktin me mbeturinat e shtëpisë.
- ▶ Përkundrazi, dërgojeni produktin në një vend grumbullimi për pajisje të vjetra elektrike dhe elektronike.



----- **Ambalazhi** -----

- ▶ Hidheni paketimin siç duhet.
- ▶ Respektoni të gjitha rregullat relevante.

## Informacioni për produktin 6

### 6.8 Të dhënat e produktit sipas rregullores së EU Nr. 811/2013, 812/2013

Efikasiteti i ngrohjes së dhomës e varur nga stinët te pajisjet me rregullator të integruar e sipas kushteve të motit, përfshirë funksionin e aktivizueshëm të termostatit të dhomës, përmban faktori e korigjimit të kategorisë së teknologjisë së rregullatorit VI. Në rastin e çaktivizimit të këtij funksioni është i mundur ndryshimi i efikasitetit të ngrohjes së dhomës në varësi të kushteve të motit.

Kategoria e çelësit të temperaturës	VI
Kontribut për efikasitetin e energjisë për ngrohjen e ambienteve në varësi të stinëve në	4,0 %

### 6.9 Të dhënat teknike

#### 6.9.1 Çelësi rregullues

Lloji i baterisë	LR06
Goditjet e matura të tensionit	330 V
Fasha e frekuencës	868,0 ... 868,6 MHz
fuqia transmetuese maks.	< 25 mW
Mbulimi në fushë të lirë	≤ 100 m
Mbulimi në godina	≤ 25 m
Niveli i ndotjes	2
Lloji i mbrojtjes	IP 20
Kategoria mbrojtëse	III
Temperatura për testimin e presionit me sferë	75 °C
Temperatura maksimale e lejuar e mjedisit	0 ... 60 °C
lagështia aktuale e dhomës	35 ... 95 %
Aplikimi	Tipi 1
Lartësia	109 mm
Gjerësia	175 mm
Thellësia	27 mm

#### 6.9.2 Njësia e marrësit të valëve radio







Tensioni i matur	9 ... 24 V ---
Rryma nominale	< 50 mA
Goditjet e matura të tensionit	330 V
Fasha e frekuencës	868,0 ... 868,6 MHz
fuqia transmetuese maks.	< 25 mW
Mbulimi në fushë të lirë	≤ 100 m
Mbulimi në godina	≤ 25 m
Niveli i ndotjes	2
Lloji i mbrojtjes	IP 21
Kategoria mbrojtëse	III
Temperatura për testimin e presionit me sferë	75 °C
Temperatura maksimale e lejuar e mjedisit	0 ... 60 °C
lagështia relative e ambientit	35 ... 90 %
Prejra tërthore e kablove lidhës	0,75 ... 1,5 mm <sup>2</sup>
Lartësia	115,0 mm
Gjerësia	142,5 mm
Thellësia	26,0 mm

# Shtojcë


## Shtojcë

### A Zgjidhja e defekteve, njoftimi për mirëmbajtje

#### A.1 Zgjidhja e defektit

Defekti	Shkaqet e mundshme	Masa
Ekрани qëndron i errët	Bateritë janë të shkarkuara	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Ndërroni të gjitha bateritë. (→ Faqe 42)</li><li>2. Nëse problemi vazhdon të jetë i pranishëm, njoftoni specialistin.</li></ol>
	Defekt në softuer	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Shtypeni butonin lart djathtas në çelësin rregullues më gjatë se 5 sekonda, për ri ndezjen.</li><li>2. Fikeni dhe ndizeni sërish çelësin e rrejtë tek gjeneratori i nxehtësisë, i cili regjistron rregullatorin.</li><li>3. Nëse problemi vazhdon të jetë i pranishëm, njoftoni specialistin.</li></ol>
Asnjë ndryshim në tregues për elementët komandues	Defekt në softuer	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Shtypeni butonin lart djathtas në çelësin rregullues më gjatë se 5 sekonda, për ri ndezjen.</li><li>2. Fikni çelësin e rrejtë në gjithë gjeneratorët e nxehtësisë për rreth 1 minutë dhe ndizeni atë sërish.</li><li>3. Nëse njoftimi i problemit vazhdon të shfaqet, atëherë njoftoni teknikun profesionist.</li></ol>
Ekрани: <b>F. Gabim në pajisjen ngrohëse</b> , në ekran shfaqet kodi konkret i gabimit, p.sh. F.33 me pajisjen ngrohëse konkrete	Defekt në pajisjen ngrohëse	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Hiqni defektin nga pajisja fillimisht duke <b>Rivendosur parametrat e fabrikës</b> dhe më pas zgjidhni <b>Po</b>.</li><li>2. Nëse njoftimi i problemit vazhdon të shfaqet, atëherë njoftoni teknikun profesionist.</li></ol>
Ekрани: Nuk e kuptoni gjuhën e vendosur	Është vendosur gjuha e gabuar	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Shtypeni  2 herë.</li><li>2. Lundroni në pikën e fundit të menisë  RREGULLIMET) dhe konfirmojeni me .</li><li>3. Nën  RREGULLIMET zgjidhni pikën e dytë të menisë dhe konfirmojeni me .</li><li>4. Zgjidhni gjuhën që kuptoni dhe konfirmojeni me .</li></ol>

## A.2 Njoftimi i mirëmbajtjes

#	Njoftim	Përshkrimi	Procese mirëmbajtjeje	Interval	
1	<b>Mungesë uji: Ndiqni të dhënat në gjenerat.e nxeht.</b>	Në impiantin e ngrohjes, presioni i ujit është shumë i ulët.	Për mbushjen me ujë gjeni informacione në udhëzuesin e përdorimit të gjeneratorit përkatës të nxehtësisë	Shihni manualin e përdorimit të gjeneratorit të nxehtësisë	

## B -- Zgjidhja e problemeve, defekteve, njoftimet e mirëmbajtjes

### B.1 Zgjidhja e defektit


Defekti	Shkaqet e mundshme	Masa
Ekрани qëndron i errët	Bateritë janë të shkarkuara	▶ Ndërroni të gjitha bateritë. (→ Faqe 42)
	Produkti ka defekt	▶ Ndërroni produktin.
Asnjë ndryshim në tregues për elementët komandues	Defekt në softuer	1. Nxirrini të gjitha bateritë. 2. Vendosini bateritë sipas polaritetit të dhënë në folenë e baterive.
	Produkti ka defekt	▶ Ndërroni produktin.
Nuk është e mundur të kalohet në nivelin profesional	Kodi për nivelin e specialistit i panjohur	▶ Vendosni sërish në çelësin rregullues rregullimet e fabrikës. Të gjitha vlerat e vendosura do të humbasin.

### B.2 Ndrejja e defekteve

Njoftim	Shkaqet e mundshme	Masa
Komunikimi me gjeneratorin e nxehtësisë <sup>1</sup> u ndërpre	Kablli ka defekt	▶ Ndërroni kabllin.
	Lidhja e spinës nuk është e saktë	▶ Testoni lidhjen e spinës.
Komunikimi me telekomandimin 1 u ndërpre	Bateritë e telekomandës me valë janë të shkarkuara	▶ Ndërroni gjithë bateritë (→ Udhëzuesi i përdorimit dhe instalimit të telekomandës me valë).
Sinj.i sens.të temp.së dhomës në çelësin rregull. i pavlefshëm	Sensori i temperaturës së dhomës ka defekt	▶ Ndërroni rregullatorin.

# Shtojcë

## B.3 Njoftimi i mirëmbajtjes

#	Njoftim	Përshkrimi	Procese mirëmbajtjeje	Interval	
1	<b>Gjeneratori i nxehtësisë 1 kërkon mirëmbajtje</b>	Për gjeneratorin e nxehtësisë ka procese mirëmbajtjeje.	Proceset e mirëmbajtjes i gjeni në udhëzuesin e përdorimit dhe të instalimit të gjeneratorit përkatës të nxehtësisë	Shihni manualin e përdorimit ose të instalimit të gjeneratorit të nxehtësisë	
2	<b>Mungesë uji: Ndiqni të dhënat në gjenerat.e nxeht.</b>	Në impiantin e ngrohjes, presioni i ujit është shumë i ulët.	Mungesë uji: Ndiqni të dhënat në gjeneratorin e nxehtësisë	Shihni manualin e përdorimit ose të instalimit të gjeneratorit të nxehtësisë	
3	<b>Mirëmbajtja Drejtjoni:</b>	Data kur duhet të kryhet mirëmbajtja e impiantit të ngrohjes.	Kryeni proceset e nevojshme të mirëmbajtjes	Data e regjistruar në rregullator	

## Indeksi sipas alfabetit

<b>A</b>	
Aktivizimi i asistentit të instalimit .....	42
<b>C</b>	
Çelësi rregullues, përcaktoni vendin e montimit.....	41
<b>D</b>	
Defekt .....	42
Defektet .....	42
Dokumentet .....	44
<b>E</b>	
Ekrani .....	30
Elementet shërbyese.....	30
<b>F</b>	
Funksionet e komandimit dhe të treguesve.....	32
Futeni, çelësin rregullues në mbajtësin e pajisjes .....	42
Futni çelësin rregullues, në mbajtësin e pajisjes .....	42
<b>K</b>	
Kablo, prerje tërthore minimale .....	39
Kabllo, gjatësia maksimale.....	39
Kabllo, zgjedhja .....	39
Kualifikimi .....	27
Kushtet paraprake për vënien në punë të impiantit nxehtësë .....	42
Kushtet paraprake, vënia në punë .....	42
<b>L</b>	
Lexoni numrin e artikullit.....	44
Lexoni numrin serial .....	44
<b>M</b>	
Mënjanimi .....	44
Mirëmbajtja .....	42
Montimi, çelësi rregullues në mbajtësin e pajisjes .....	41
Montimi, njësia e marrësit në mur .....	39
Montimi, njësia e marrësit te gjeneratori i nxehtësisë .....	39
Montoni mbajtësin e pajisjes në mur .....	41
Montoni në mur njësinë marrëse të valëve radio .....	39
Montoni njësinë e marrësit te gjeneratori i nxehtësisë .....	39

Montoni njësinë e marrësit, te gjeneratori i nxehtësisë .....	39
<b>N</b>	
Ndërimi i baterive .....	42
Ngrica .....	28
Numri i artikullit.....	44
Numri serial .....	44
<b>P</b>	
Përcaktoni forcën e sinjalit të çelësit rregullues.....	41
Përcaktoni forcën marrëse të çelësit rregullues.....	41
Përcaktoni vendin e montimit të çelësit rregullues.....	41
Përdorimi sipas destinimit .....	26
Polariteti .....	39
<b>R</b>	
Riciklimi .....	44
Rregullore .....	28
<b>S</b>	
Shenja-CE .....	44
Shmangni funksionin e defektit .....	30
<b>T</b>	
Tekniku profesionist .....	27
<b>V</b>	
Veglat .....	28
Vendosni grafikun e ngrohjes.....	30

# Sadržaj

## Uputstva za rad i instalaciju

### Sadržaj

<b>1</b>	<b>Bezbednost</b> .....	<b>51</b>
1.1	Upozoravajuće napomene koje se odnose na postupanje.....	51
1.2	Pravilno korišćenje.....	51
1.3	Opšte sigurnosne napomene.....	52
1.4	 -- Sigurnost/propisi .....	53
<b>2</b>	<b>Opis proizvoda</b> .....	<b>54</b>
2.1	Koja nomenklatura se koristi?.....	54
2.2	Šta uzrokuje funkciju zaštite od smrzavanja? .....	54
2.3	Šta znače sledeće temperature? .....	54
2.4	Šta je zona? .....	54
2.5	Šta je cirkulacija?.....	54
2.6	Šta označava vremenski prozor?.....	54
2.7	Sprečavanje neispravnog funkcionisanja .....	55
2.8	Podešavanje krive grejanja.....	55
2.9	Displej, elementi za rukovanje i simboli.....	55
2.10	 -- Primena regulatora .....	57
2.11	Funkcije rukovanja i prikaza .....	57
<b>3</b>	 -- <b>Električna instalacija, montaža</b> .....	<b>63</b>
3.1	Provera obima isporuke .....	63
3.2	Izbor vodova .....	63
3.3	Polaritet.....	63
3.4	Instaliranje jedinice za prijem signala .....	63
3.5	Montaža regulatora .....	64
<b>4</b>	 -- <b>Puštanje u rad</b> .....	<b>66</b>
4.1	Preduslovi za puštanje u rad .....	66
4.2	Početak rada sa instalacionim asistentom .....	66
4.3	Kasnija promena podešavanja ....	66
<b>5</b>	<b>Smetnja, poruke o grešci i poruke o servisu</b> .....	<b>66</b>
5.1	Poruka o grešci.....	66
5.2	Poruka o servisu .....	66
5.3	Zamena baterije.....	66
<b>6</b>	<b>Informacija o proizvodu</b> .....	<b>68</b>
6.1	Poštujte i čuvajte važeću dokumentaciju.....	68
6.2	Oblast važenja uputstava .....	68
6.3	Tipska pločica .....	68
6.4	Serijski broj .....	68
6.5	CE-oznaka .....	68
6.6	Garancija i servisna služba za korisnike.....	68
6.7	Reciklaža i odlaganje otpada.....	68
6.8	Podaci o proizvodu shodno uredbi EU br. 811/2013, 812/2013.....	68
6.9	Tehnički podaci.....	69
	<b>Dodatak</b> .....	<b>70</b>
<b>A</b>	<b>Otklanjanje smetnji, poruka o održavanju</b> .....	<b>70</b>
A.1	Otklanjanje smetnji .....	70
A.2	Servisne poruke .....	71
<b>B</b>	 -- <b>Otklanjanje smetnji, grešaka, poruka o održavanju</b> .....	<b>71</b>
B.1	Otklanjanje smetnji .....	71
B.2	Otklanjanje greške .....	71
B.3	Servisne poruke .....	71
	<b>Spisak ključnih reči</b> .....	<b>73</b>

## 1 Bezbednost

### 1.1 Upozoravajuće napomene koje se odnose na postupanje

#### Klasifikacija upozorenja koja se odnose na određenu aktivnost

Upozoravajuće napomene prema vrsti radnje su uz pomoć znaka upozorenja i signalnih reči klasifikovane u pogledu stepena ozbiljnosti moguće opasnosti:

#### Znakovi upozorenja i signalne reči



#### **Opasnost!**

Neposredna opasnost po život ili opasnost od teških povreda ljudi



#### **Opasnost!**

Opasnost po život zbog strujnog udara



#### **Upozorenje!**

Opasnost od lakih povreda ljudi



#### **Oprez!**

Rizik od materijalne štete ili štete po životnu sredinu

### 1.2 Pravilno korišćenje

Pri nepravilnoj ili nenamenskoj upotrebi može doći do negativnih posledica po proizvod i druge materijalne vrednosti.

Proizvod je za to predviđen da reguliše grejni sistem pomoću generatora toplote istog proizvođača sa eBUS portom.

Regulator reguliše u zavisnosti od instaliranog sistema:

- Grejanje
- Priprema tople vode
- Cirkulacija

Namenska upotreba obuhvata:

- poštovanje svih priloženih dokumenata proizvoda, kao i svih ostalih komponenata sistema
- instalaciju i montažu u skladu sa dozvolom za proizvod i za sistem

Upotreba u skladu sa odredbama osim toga obuhvata instalaciju prema IP šifri.

Ovaj proizvod mogu da koriste deca od 8 godina i naviše kao i lica sa smanjenim psihičkim, senzornim ili mentalnim sposobnostima ili nedostatkom iskustva i znanja, ukoliko su pod nadzorom ili su vezano za sigurnu upotrebu proizvoda podučeni i razumeju opasnosti koje iz toga mogu da nastanu. Deca

# 1 Bezbednost

ne smeju da se igraju sa proizvodom. Čišćenje i korisničko održavanje ne smeju da vrše deca bez nadzora.

Upotreba koja se razlikuje od one opisane u ovom uputstvu ili upotreba koja izlazi izvan okvira ovde opisane upotrebe, smatraće se nenamenskom.

## 1.3 Opšte sigurnosne napomene

### 1.3.1 Opasnost od pogrešnog rukovanja

Zbog pogrešnog rukovanja možete sami sebi da naškodite i da prouzrokuje materijalnu štetu.


- ▶ Pažljivo pročitajte priloženo uputstvo i sva važeća dokumenta, naročito poglavlje „Sigurnost“ i upozoravajuće napomene.
- ▶ Sprovedite aktivnosti samo kao što su opisane u priloženom uputstvu za rad.

### 1.3.2 Opasnost zbog nedovoljne kvalifikacije

Sledeće radove smeju da obavljaju isključivo serviseri koji su za to dovoljno kvalifikovani:

- Montaža
- Demontaža
- Instalacija
- Puštanje u rad
- Stavljanje van pogona

- ▶ Postupajte u skladu sa aktuelnim stanjem tehnike.

Rad i funkcije, koje mogu da se izvrše odnosno podese samo od strane servisera, označene su simbolom .

### 1.3.3 Opasnost od povreda zbog baterija

Ako se baterije nenamenski pune, moguće su znatne povrede lica.

- ▶ Nemojte ponovo da puniti baterije.
- ▶ Nemojte da kombinujete baterije različitog tipa.
- ▶ Nemojte da kombinujete nove i korišćene baterije.

### 1.3.4 Rizik od materijalnog oštećenja

- ▶ Nemojte kratko spajati kontakte priključka u pregradi za baterije proizvoda.

### 1.3.5 Rizik od materijalnog oštećenja zbog korozije

- ▶ Izvadite iskorišćene baterije iz proizvoda i odložite ih na odgovarajući način.
- ▶ Ako odlažete proizvod na duži vremenski period, prethodno uklonite baterije.



### 1.3.6 Opasnost od pogrešnog rukovanja

Zbog pogrešnog rukovanja možete sami sebi da naškodite i da prouzrokuje materijalnu štetu.

- ▶ Pažljivo pročitajte priloženo uputstvo i sva druga važeća dokumenta, naročito poglavlje „Sigurnost“ i upozoravajuće napomene.
